

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E HENE 14 SHTATOR 2023

E nderuar zonja Kryetare e seancës dhe e Parlamentit, shumë faleminderit për fjalën!

Të nderuar kolegë, ministra dhe deputetë,

Nga potpuria e gënjeshtreve të vogla dhe të mëdha të parafolësit, sipas listës dhe jo sipas radhës, me shumë mund do të doja të veçoja një të vërtetë, sepse aty pati një të vërtetë, megjithëse ishte një e vërtetë, e cila u zvogëluar. Më në fund, shqiptarët e Malit të Zi do të kenë shkollën shqipe dhe këtë akt të qeverisë malazeze e përshëndesim ne dhe çdo shqiptar, por pjesa që i mungon të vërtetës është se, për shkak se po diskutojmë marrëveshjen me Malin e Zi për sigurimet shoqërore, ka një të vërtetë më të madhe, e cila duhet thënë: me modelin e saj, Shqipëria vazhdon të bashkëpunojë me të gjitha vendet e rajonit jo vetëm për të drejtat e pakicave, por, në rastin konkret, për këtë marrëveshje, të cilën e kemi për ta miratuar sot, për të siguruar trajtim të barabartë të qytetarëve të saj, në radhë të parë, kur ata dalin jashtë kufijve të saj. Madje, gjëja e parë që duhet thënë dhe që duhet ta dëgjojnë të gjithë qytetarët është se kjo marrëveshje pason një seri të gjatë marrëveshjesh, për të cilat kjo qeveri ka punuar pa pushim, pa ndërprerje, tërësisht e fokusuar dhe tërësisht e qartë se shqiptarët, të cilët dalin nga kufijtë tanë, për çdo orë pune që kanë kryer në të kaluarën, por edhe sot e nesër, duhet të trajtohen në mënyrë dinjitoze. Unë do t'i bëja jehonë parashtrimit plot fakte dhe argumente të kolegut Braçe, i cili jo vetëm i rreshtoi marrëveshjet, jo vetëm i citoi kampionët e zbatimit të marrëveshjeve, si Gjermania, për shembull, por tërhoqi edhe vëmendjen për faktin që janë disa marrëveshje, njëra në një fazë diskutimi dhe tjetra gati për firmosje, me 2 fqinjët tanë të mirë, me Greqinë dhe me Italinë.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Për të qëndruar në pikën e rendit të ditës që po diskutojmë dhe për të mos u shpërndarë në histori krimbashi, si te barsolleta e krimbit, duke folur vetëm për krimba korrupsioni, të cilët, në radhë të parë, duhet t'i shohim mirë se ku ndodhen, duhet të qëndrojmë tek thelbi i ditës. Thelbi i rendit të ditës është që Shqipëria siguron trajtim të barabartë dhe vazhdon të ulet në tryeza me fqinjët e saj, për të sjellë një realitet pararendës të *acquis communautaire-it*, pra qytetarët të lëvizin të lirë, sepse të drejtat e tyre mbrohen njësoj si në vendet ku ata shkojnë dhe, në rastin konkret, kur ata vijnë në Shqipëri. Kjo është e vërteta e parë. E vërteta e dytë, që duhet thënë, është se ne vazhdojmë të jemi një model shumë i mirë fqinjësie. I dëgjova kolegët, të cilët janë gati ta marrin Shqipërinë për t'i bërë karikatura e lloj-lloj gjërash. Kolegë, sot ne këtu qëndrojmë përpara një realiteti dhe një fakti që, Shqipëria në marrëveshjet dhe në marrëdhëniet që ka me fqinjët, por edhe kur përfaqësojmë rajonin së bashku me fqinjët, vazhdon të jetë model i një fqinjësie të mirë. Pavarësisht se brenda Shqipërisë ka lloj-lloj njerëzish, të cilët duan t'i fryjnë aty- këtu ndonjë zjarri të vjetër, i cili besoj se këtu te ne është shuar me kohë, por mund të ketë ngelur në vende të tjera, si një shovinizëm i sëmurë apo si një patriotizëm i sëmurë, rasti konkret tregon se ne vazhdojmë të ulemi në tavolinë me fqinjët tanë dhe të bëjmë punë të mira për qytetarët e vendeve përkatëse. Është edhe një e vërtetë tjetër shumë e rëndësishme, sepse dëgjova një nga kolegët të tallej me skemën e pensioneve, por faktet, shifrat, tregojnë një histori tjetër. Të nderuar pensionistë, patjetër që dëgjuat t'ju qante hallin edhe pensionisti më i mirëpaguar, por faktet dhe shifrat tregojnë, së pari, se skema e pensioneve është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme, qoftë nga numri i kontribuuesve, që tregon formalizim të ekonomisë, qoftë edhe nga kontributi që ata ofrojnë.

Kjo do të thotë që sot skema e sigurimeve është një skemë më e shëndetshme, më likuide dhe më e gatshme për t'iu përgjigjur të gjithë pensionistëve në Republikën e Shqipërisë. E vërteta tjetër brenda asaj skeme është transferimi nga buxheti i shtetit në familjet shqiptare, përveç pensionit në vlerë nominale, pra pensionit absolut që marrin. Jam duke folur për trajtimet kur qeveria ka qenë pararendëse, si në rastin e krizës energjetike, pra, mbështetja që iu dha pensionistëve ndaj efekteve që solli kriza energjetike, megjithëse nuk u rrit çmimi i energjisë. Pra, jo vetëm subvencionimi i çmimit të energjisë, por edhe rritja e pensionit për të përballuar rritjen pak a shumë që pati shporta, gjithashtu, është një shifër goxha e konsiderueshme që lëviz nga buxheti i shtetit drejt familjeve shqiptare. Shifrat janë kokëforta, shifrat flasin me efektet që krijojnë, nuk janë si ne që ndoshta përpiqemi të tregojmë histori këtu dhe nuk fusim asgjë në xhepin e shqiptarëve. Çdo shqiptar, çdo zonjë dhe çdo zotëri, e dinë shumë mirë se sa janë transferuar në portofolin e tij, qoftë në momentet e krizës energjetike, qoftë në momentet e krizës së inflacionit, qoftë në momentet e tërmetit e të pandemisë, qoftë në momentet e rimbursimit të ilaçeve. Pra, çdo njeri e di shumë mirë që janë si nata me ditën, ajo ku kemi qenë me pensionistin më të mirëpaguar dhe ajo ku jemi sot me qeverinë e punës, që është këtu pas meje. Kështu që, kolegë, do t'ju ftoja të flisnim për rendin e ditës, dhe për Gjykatën Kushtetuese do t'ju thosha të duronit, se e kemi në pikën e fundit të rendit të ditës! Unë e di që ju lodheni dhe doni të ikni për ndonjë pushim të vogël, por duroni, sepse do ta diskutojmë kur t'i vijë radha!

Faleminderit!